

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 11.614 HA të llojit kullotë në fshatin Derven për vendosje stacionesh, bazamentesh për panele fotovoltaike me qellim prodhim energjie.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara të interesit të fshatit Derven të Bashkisë Krujë dhe komunitetit që preket nga dhënia në përdorim e sipërfaqes së kullotës prej 11.614 Ha për vendosje stacionesh, bazamentesh për panele fotovoltaike për prodhim të energjisë, ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me këtë çështje.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në ambjentet e restorant Tan Luka, në fshatin Derven, në datë **20/12/2022, ora 11:00.**

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura deri më datë 22 Dhjetor 2023, në adresën e emailit:

gjon1986_jur@live.com

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Kryetar/Nënkryetar/Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinator i Njoftimit dhe Konsultimit Publik, drejtues/punonjës të administratës, drejtorja e buxhetit dhe financës, sektori pyjeve dhe kullotave, Kryetarët e Fshatrave dhe Administratorët e Njësive Administrative.
- **Nga komuniteti:** Banorët fshatit Derven në Bashkisë Krujë, anëtarët e shoqërisë civile, përfaqësues të komunitetit, grupe të ndryshme të interesit apo grupet e marginalizuara, etj.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik në terren synon konsultimin për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 11.614 HA të llojit kullotë në fshatin Derven për vendosje stacionesh, bazamentesh për panele fotovoltaike me qellim prodhim energjie.
Përshkrimi i çështjes.	Miratimi i draftit vendimit dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 11.614 HA të llojit kullotë në fshatin Derven për vendosje stacionesh, bazamentesh për panele fotovoltaike me qellim prodhim energjie është i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi bëhet fjalë për një sipërfaqe të konsiderueshme të llojit kullotë në fshatin Derven, vendim ky që duhet të konsultohet patjetër me grupet e interesit që preken. Mbi këtë çështje, është vendosur që në zbatim dhe të kuadrit ligjor në fuqi, të bashkëbisedohet dhe merren mendimet e komunitetit dhe adresojnë nevojat e tyre përsa i përket kësaj vendimmarrjeje. Për këtë, Këshilli i Bashkisë së bashku me administratën e Bashkisë do të organizojnë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresën e emailit të sekretarisë së Këshillit Bashkiak dhe Koordinatorit për Konsultimin me Publikun, BRENDA DATËS 22 Dhjetor 2023. gjon1986_jur@live.com

	Adresa: Restorant Tan Luka Fshati Derven, Bashkia Krujë.
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit : Ndryshime dhe sugjerime e komunitetit për këtë projektvendim do të mbahen me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga sektori i pyjeve të Bashkisë.
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me çështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, në link më poshtë: https://kruja.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/Ortofoto.pdf https://kruja.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/Raport-Teknik.pdf https://kruja.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/Relacion-per-dhenien-ne-perdorim-te-kullotes-fshati-Derven.pdf
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Dërgimi i sugjerimeve të komunitetit do të jetë i mundur deri në 22 Dhjetor 2023 , nëpërmjet adresës së emailit: gjon1986_jur@live.com Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Komisionit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Pronave të Bashkisë, komisionit të Ekonomise dhe Financës, dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të e Bujqësisë, Pyjeve dhe Pronave të Bashkisë dhe komisionit të Ekonomise dhe Financës (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun) të cdo rekomandimi dhe dërgimi i tyre tek Kryetari i Bashkisë; 4. Kthimi i përgjigjes dhe rekomandimeve nga ana e Kryetari te Bashkise. 5. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt vendim. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit vjetor; 6. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 7. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre; 8. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 9. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 10. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	5.12.2023